



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës - Vlada Republika - Government of Kosovo MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Nr./la Org. Org. Jedini Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	351
Nr. f.faqeve Broj stranica No. pages	7	Data: Datum: Date:	23, 09/20 09
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 6 paragrafi 6.8 nënparagrafi (ii) të Ligjit “Për Metrologji” Nr. 02/L-34, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 2009/20

PËR KUSHTET PËR AUTORIZIMIN E PËRSONAVE JURIDIK APO FIZIK PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE NË QENDRAT E KONTROLLIMIT TEKNIK TË AUTOMJETEVE

Neni 1 Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kushtet që duhet t'i plotësojnë personat juridik apo fizik të autorizuar për verifikimin e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara, të cilat përdoren në qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve ngasëse me motor dhe rimorkiove (në vazhdim të tekstit - automjetet).

Neni 2

1. Personat juridik apo fizik të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara, mund të kryejnë testimin e konformitetit të mjeteve matëse me kërkesat tekniko-metrologjie (në vazhdim të tekstit – testimin), verifikimin e tyre si dhe matjet zyrtare.

2. Në kuptim të këtij udhëzimi administrativ, mjete matëse ligjërisht të kontrolluara të cilat i nënshtrohen testimit të konformitetit dhe verifikimit janë instrumentet matëse në vijim:

- 2.1. Instrumentet për përcaktimin e forcës frenuese në diskun e rrotës tek automjetet;
- 2.2. Instrumentet matëse për kontrollimin e presionit në pneumatikët e automjeteve;
- 2.3. Instrumentet matëse për kontrollimin e gazrave të nxjerra nga mjetet motorike;
- 2.4. Instrumentet matëse për kontrollimin e ngarkesës së lejuar maksimale në boshtet e automjeteve.

Neni 3

Kushtet dhe kërkesat tekniko - metrologjike që duhet plotësuar nga personat juridik apo fizik

1. Personi juridik apo fizik duhet t'i plotësoj kushtet dhe kërkesat tekniko-metrologjike të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ dhe dispozita tjera ligjore që e rregullojnë këtë fushë, siq janë:

- 1.1. të posedoj pajisje teknike, hapësirë dhe personel të nevojshëm profesional për kryerjen e aktiviteteve për të cilat kërkohet autorizimi;
- 1.2. të siguroj krahasueshmërinë e pajisjeve/etalonëve matëse të cilat i përdorë;
- 1.3. të mos merret me prodhimin, importimin, shitjen apo riparimin e instrumenteve matëse nga fushat e autorizimit;
- 1.4. të ofroj garancion bankar në vlerë prej 100.000,00 € për kompensimin e dëmeve të shkaktuara gjatë punës e tyre dhe ndaj personave të tretë;
- 1.5. etalonët për testimin dhe verifikimin e instrumenteve matëse;
- 1.6. dokumentacionin mbi procedurat e testimit dhe verifikimit.

Neni 4

1. Për testimin dhe verifikimin e instrumenteve matëse në qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve, serviset e autorizuar duhet ti posedojnë pajisjet/etalonët e nevojshëm me specifika si më poshtë:

- 1.1. Stabilimentin mekanik ose elektronik (matësi i gjysmë boshteve ose peshore) me dimensione dhe masë të përshtatshme të gramarëve të klasës së saktësisë M2, përkatësisht me krahun matës me manometër, dinamometër ose konvertues elektronik të forcës, të cilët japin të dhëna mbi forcën frenuese në diapazonin prej 0 deri 40 kN;
- 1.2. Instrumentin për determinizmin e fraksionit të vëllimit të komponentëve të gazrave nxjerrëse të emetuara nga makinat motorike si oksidi i karbonit (CO), dyoksidi i karbonit (CO₂), Hidrokarburet (HC) dhe oksigjenin (O) me diapazon :

CO % vol	CO ₂ % vol	O ₂ % vol	HC ppm vol
0 deri 5	0 deri 16	0 deri 21	0 deri 2000

dhe rezolucion

CO % vol	CO ₂ % vol	O ₂ % vol		HC ppm vol
		≤ 4% vol	> 4 % vol	
0 .01	0.1	0.01	0.1	1

- 1.3. Peshore të presionit matës mekanik ose shndërruesit matës. Gabimi maksimal i lejuar i etalonit mund të jetë më së shumti 20 mbar për matësit e presionit me diapazon matës deri në 4 bar, ndërsa më së shumti 25 mbar për matësit e presionit me diapazon të lejuar matës mbi 4 bar.



Neni 5

1. Gramarët e klasës të saktësisë M2 konform nenit 5 paragrafi 1 të cilët do të përdoren si pjesë e stabilimentit mekanik duhet të jenë të kalibruar.
2. Krahu matës (si instrument matës i gjatësisë) konform nenit 5 paragrafi 1 i cili përdoret si pjesë e stabilimentit mekanik duhet të ketë bartësin i cili mund të shtrëngohet (fiksohet) në mbajtësit e cilindrave lëvizës të ndërtuar vertikalisht me qëllim të vendosjes në pozicionin horizontal para fillimit të testimit. Krahu matës duhet të jetë i kalibruar.
3. Nëse për testim të pajisjeve me cilindra përdoren manometër, dinamometër ose instrumenti elektronik konvertues i forcës, të njëjtit duhet të kalibrohen.
4. Etaloni me të cilin verifikohen instrumentet për kontrollimin e gazrave të nxjerra - analizatorët e gazit duhet të jenë të kalibruar, materialet referente (bombolat me gazin referent) duhet të jenë të testuar dhe të kenë certifikatat adekuate, ndërsa të gjitha pajisjet tjera me të cilat realizohet verifikimi i analizatorit të gazrave duhet të jenë të kalibruara.

Neni 6

1. Servisi i autorizuar duhet të udhëheq evidencën mbi testimet dhe verifikimet e kryera.
2. Servisi i autorizuar është i obliguar të ruaj dokumentacionin nga testimet dhe verifikimet në një kopje elektronike dhe një kopje fizike, në afat jo më pak se 3 (tre) vite.
3. Servisi i autorizuar në vazhdimësi duhet të ketë qasje në internet dhe me bazën e të dhënave të Departamentit të Metrologjisë së Kosovës.

Neni 7

1. Për testimin dhe verifikimin e instrumenteve matëse në qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve, servisi i autorizuar duhet të posedojë hapësirë të mjaftueshme të punës që i plotëson kushtet si më poshtë:
 - 1.1. të jetë e pastër, e thatë dhe me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve, si edhe për testim dhe verifikim të pa pengueshëm të pajisjeve me cilindra;
 - 1.2. të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit;
 - 1.3. në hapësira dhe në rrethinë të mos ketë burim të vibrimit që do të ndikonte në saktësi të matjeve;
 - 1.4. të ketë ndriçim të mjaftueshëm natyror dhe artificial;
 - 1.5. të ketë termometër për matjen e temperaturës së ajrit në diapazon 0°C deri 35°C , me ndarje prej 0.5°C , të kalibruar;
 - 1.6. të ketë instrumentin për matjen e lagështisë, të kalibruar.

Neni 8

Në hapësirat punuese të destinuara për testim dhe verifikim të instrumenteve matëse duhet të vendosen pajisjet për këtë qëllim dhe kjo hapësirë nuk mund të shfrytëzohet për asnjë aktivitet tjetër.

Neni 9

Burimet e nxehtësisë në hapësirat punuese për testim dhe verifikim duhet të jenë të larguara nga pajisjet, përkatësisht nga vendi ku realizohet testimi në distancë së paku 1.5 m si dhe duhet të krijojnë mundësinë e ngrohjes lineare të të gjithë hapësirës.

Neni 10

1. Servisi i autorizuar duhet të ketë së paku dy metrolog të autorizuar të cilët kryejnë punët e testimit dhe verifikimit të instrumenteve matëse si dhe personel mbështetës të nevojshëm.
2. Përgatitja profesionale e së paku njërit metrolog të autorizuar duhet të jetë shkollim universitar profesional, ndërsa metrologu tjetër duhet të ketë së paku shkollën e mesme profesionale, të cilat duhet të dëshmohen me dokumentacion valid.
3. Metrologët e autorizuar duhet të kenë së paku 3 (tre) vite përvojë pune në punët testuese të instrumenteve matëse dhe/ose të posedojnë certifikatë të trajnimit nga fusha e autorizimit, si dhe të kenë dëshmi mbi provimin e dhënë profesional.
4. Metrologët e autorizuar duhet t'i njohin udhëzimet administrative, rekomandimet dhe metodat e testimit të instrumenteve matëse të cilat e mbulojnë këtë fushë.
5. Nëse metrologu nuk posedon dëshminë mbi provimin e dhënë profesional, këtë duhet ta bëjë më së voni 6 muaj nga fillimi i mbajtjes së provimit profesional i cili organizohet nga MTI.
6. Nëse servisi i autorizuar nuk plotëson kushtet nga paragrafi 5 i nenit 10 do të konsiderohet mosplotësim i kushteve të autorizimit.

Neni 11

1. Servisi i autorizuar duhet të posedoj dokumentet e nevojshme:
 - 1.1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
 - 1.2. Dëshminë mbi përgatitjen profesionale të metrologeve të autorizuar;
 - 1.3. Fotokopjen e noterizuar të lejes së njoftimit të metrologut të autorizuar apo dëshminë mbi rregullimin e vendqëndrimit në Kosovë, në rast se metrologu nuk është shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.4. Kontratat e punës për personelin, me validitet për së paku 3 vite;
 - 1.5. Procedurat dhe dokumentet e testimit/verifikimit të instrumenteve matëse nga fusha e autorizimit, të aprovuara nga DMK;
 - 1.6. Udhëzuesit e përdorimit, ruajtjes dhe përcjelljes së gjendjes së pajisjeve për testim dhe verifikim nga prodhuesi;
 - 1.7. Formularët e kërkesave, raporteve të testimit, certifikatave për verifikim, të aprovuara nga DMK;
 - 1.8. Regjistrin e pajisjeve për testim dhe verifikim, me të dhëna teknike dhe me certifikatat e kalibrimit për secilën pajisje/etalon ose certifikatat e verifikimit për pajisjet plotësuese, respektivisht certifikatat e testimit për materialet referente;
 - 1.9. Dëshmitë nga neni 3 paragrafi 1 pikat 1.4 dhe 1.5;

- 1.10. Dëshminë nga metrologu i autorizuar që nuk është dënuar me burgim prej se paku 3 muaj, për vepër penale me dashje;
- 1.11. Dëshminë se nuk është në procedurë të falimentimit.

Neni 12

Verifikimi i instrumenteve dhe pajisjeve matëse ligjore

1. Servisi i autorizuar mund të testoj dhe verifikoj vetëm instrumentet matëse ligjore të cilat kanë dokumentacionin valid të miratimit të tipit, të lëshuar nga një institucion kompetent dhe të lejuar për përdorim në treg nga ana e DMK-së.
2. Lejimin e përdorimit të tipit të instrumenteve matëse në territorin e Republikës së Kosovës e bën DMK, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm të instrumentit matës. Për çdo tip, DMK lëshon certifikatën e lejimit për përdorim të tipit.
3. Nëse pas procedurës së përcaktuar të testimit, vërtetohet se mjete matës është në përputhje me tipin e miratuar të tij dhe i përmbushë kërkesat tekniko - metrologjike të parapara, metrologu i autorizuar i servisit të autorizuar duhet ta vërtetoj instrumentin matës.
4. Verifikimi i instrumenteve matëse ligjore mund të jetë fillestar, i rregullt apo i jashtëzakonshëm.
5. Servisi i autorizuar është i obliguar të bëjë verifikimin edhe kur instrumenti matës është i shënuar me shenjë verifikuese.
6. Procedurat e testimit dhe verifikimit të llojeve të caktuara të instrumenteve matëse përcaktohen me Udhëzime Administrative të veçanta, apo me rregullore teknike të pranuar që specifikojnë kërkesat tekniko-metrologjike.
7. Periudha e verifikimit, kompensimet dhe shërbimet e verifikimit për instrumentet matëse ligjore të caktuara nga neni 2 paragrafi 2 janë të rregulluara me Udhëzim Administrativ të veçantë.

Neni 13

Ndërprerja e Vlefshmërisë së vërtetimit

1. Vlefshmëria e vërtetimit të instrumenteve matëse ligjorisht të kontrolluara ndërpritet, nëse:
 - 1.1. ka skaduar validiteti i vërtetimit;
 - 1.2. në instrumentin matës janë bërë ndryshime të cilat mund të ndikojnë në karakteristikat metrologjike të tij;
 - 1.3. instrumenti matës është dëmtuar në atë masë sa ka humbur ndonjë veti të rëndësishme që është objekt verifikimi;
 - 1.4. shenja vërtetuese është e dëmtuar, e ndryshuar, e hequr, apo në ndonjë mënyrë tjetër është dëmtuar;
 - 1.5. shihet qartë se mjete matës ka humbur vetit e nevojshme metrologjike edhe nëse shenja vërtetuese nuk është e dëmtuar;
 - 1.6. vendi i instalimit të mjeteve është ndërruar.

Neni 14
Shenjat e verifikimit

Lloji, forma dhe mënyra e vendosjes së shenjave të vërtetimit të cilat përdoren për verifikimin e mjeteve matëse ligjore, si edhe forma dhe përmbajtja e vërtetimit/certifikatës së verifikimit është e përcaktuar me udhëzim administrativ në fuqi.

Neni 15
Detyrimet e servisit të autorizuar

1. Servisi i autorizuar, përveç kërkesave të përshkruara me dispozita të ligjit për metrologji dhe me këtë udhëzim administrativ duhet:

- 1.1. Të kryejë profesionalisht veprimtarinë nga autorizimi dhe në vazhdimësi në pajtim me rregullat dhe vendimin për autorizim;
- 1.2. Të testoj dhe verifikoj vetëm instrumentet matëse të cilat kanë leje përdorimi;
- 1.3. Të njoftoj DMK-në në afat prej 3 (tre) ditësh për çfarëdo ndryshimi të kushteve të autorizimit;
- 1.4. Të paraqesë në DMK regjistrin e pajisjeve/etalonëve bashkë me certifikatat e kalibrimit/verifikimit së paku një herë në vit, ose kur kjo i kërkohet gjatë mbikëqyrjes nga zyrtarët përgjegjës të DMK-së;
- 1.5. Të paraqes raportin vjetor të punës në DMK, jo më vonë se 31 janar i vitit pasues;
- 1.6. Të mundësojnë kryerjen e mbikëqyrjes metrologjike sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Servisi i autorizuar i cili vepron në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kundër vendimit të autorizimit, të njëjtit i shfuqizohet vendimi i autorizimit, si dhe i njëjti nuk mund të parashtoj kërkesë të re për autorizim në afatin kohor 5(pesë) vjeçar nga dita e anulimit.

Neni 16
Mbikëqyrja metrologjike

1. DMK kryen mbikëqyrjen metrologjike për:

- 1.1. Instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara që përdoren në qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve;
- 1.2. Punën e metrologëve të autorizuar;
- 1.3. Zbatimin e dispozitave ligjore të këtij udhëzimi administrativ dhe dispozitave tjera që rregullojnë punën e serviseve të autorizuara.

Neni 17
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Personit juridik apo fizik i cili i plotëson kushtet e përshkruara me këtë udhëzim administrativ i lëshohet vendimi për autorizim i cili vlen 3 (tri) vite nga dita e dhënies së autorizimit.

2. Vazhdimi, ripërtëritja e autorizimit kryhet në procedurë të njëjtë sikurse në rastin e dhënies së autorizimit.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohen të gjitha aktet nënligjore juridike të cilat e kanë rregulluar këtë fushë.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ministri i MTI-së.

Prishtinë 23.09.2009

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë
Lutfi Zharku

